

MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHIMIT TË ZGJEDHJEVE
Republika e Shqipërisë — Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore
18 shkurt 2007

DEKLARATË E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

Tiranë, 19 shkurt 2007 – Në vijim të ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për të vëzhguar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në vitin 2007, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) në Shqipëri dhe Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale në Evropë i Këshillit të Evropës dërgoi një delegacion të përfaqësuesve evropianë të autoriteteve vendore. Për vëzhgim në ditën e zgjedhjeve, vëzhgues nga OSBE/ODIHR-i dhe Kongresi u bashkuan për të formuar një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ).

MNVZ-ja shqyrtoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me Angazhimet e OSBE-së, angazhime të Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionin vendas. Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake lëshohet para përfundimit të procesit zgjedhor, përfshirë numërimin e votave dhe nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare, si dhe përfundimit të afateve ligjore për ankimet dhe apelimet. Një vlerësim përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i këtyre fazave të mbetura të procesit. OSBE/ODIHR-i do të nxjerrë një raport përfundimtar gjithëpërfshirës afërsisht dy muaj pas përfundimit të procesit dhe Kongresi do të votojë mbi një raport në Sesionin e tij të Pranverës.

PËRFUNDIME PARAPRAKE

Megjithëse zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 18 shkurtit siguruan kushtet për një garë konkurruese, ato ishin një tjetër mundësi e humbur për Shqipërinë për të zhvilluar zgjedhje plotësisht në përputhje me Angazhimet e OSBE-së, angazhime të Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Partitë politike nuk respektuan përgjegjësitë e konsiderueshme që u ishin dhënë nga ligji. Megjithëse dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë, votimi u shënuar nga mangësi procedurale dhe në disa vende nga tensioni.

Mjedisi zgjedhor u shënuar nga pasiguri dhe mungesë besimi midis aktorëve kyç në zgjedhje, veçanërisht në periudhën para marrëveshjes së 12 janarit, që synonte të rifillonte procesin e bllokuar. Kjo u theksua nga një vendim i opozitës për të mos marrë pjesë fillimisht në proces. Mungesa e angazhimit konstruktiv nga partitë politike çoi në bllokim. Kjo ringjalli shqetësime të mëparshme mbi vullnetin e partive për të siguruar që zgjedhjet të zhvillohen në përputhje me standarde ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Shqipëria vazhdon të mos ketë një sistem të besueshëm të gjendjes civile dhe të identifikimit dhe as një sistem të njëtrajtshëm adresash. Kjo shkaktoi, edhe njëherë, mosmarrëveshje për hartimin e listave të zgjedhësve dhe identifikimin e zgjedhësve në qendrat e votimit. Derisa këto sisteme të implementohen plotësisht, zgjedhjet në Shqipëri do të përballeshin me vështirësi të tilla. Kërkohej përpjekje e vendosur nga ana e autoriteteve shqiptare, përfshirë mbështetje të gjerë nga partitë politike, para Zgjedhjeve për Kuvendin që priten në vitin 2009. Partitë politike duhet të heqin dorë nga keqpërdorimi i kësaj çështjeje në debatet e tyre politike.

Përgjithësisht, kandidatët dhe partitë politike mundën të regjistroheshin pa pengesa dhe ishin në gjendje t'i tejçonin lirshëm elektrostatin pikëpamjet e tyre. Në përgjithësi, mediat e pasqyruan në mënyrë të balancuar fushatën, e cila u mbizotërua nga çështje me domethënie kombëtare më tepër se çështje politike lokale. Konkurenca e vërtetë ishte e dukshme dhe zgjedhësit ishin në gjendje të informoheshin për të zgjedhur midis mundësive të shumta konkurruese. Sidoqoftë, gjatë javës para ditës së zgjedhjeve, toni i fushatës degjeneroi për shkak të sulmeve të personalizuara karshi garuesve kryesorë. Gjithashtu, u vërejtën një numër i vogël incidentesh të dhunshme.

Në përgjithësi, zhvillime pozitive përfshijnë:

- Kuadri ekzistues ligjor siguron, në një masë të madhe, një bazë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, nëse zbatohet në mirëbesim. Ndryshimet e miratuara më 13 janar 2007 trajtuan një numër rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it.
- Deri tani, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ishte në gjendje të menaxhonte procesin zgjedhor në një masë të madhe në përputhje me ligjin, pavarësisht afateve ligjore të ngjeshura dhe mjedisit të pasigurtë.
- Procesi i përditësimit të listave të zgjedhësve, ndonëse i ngutur në një numër njësisish të qeverisjes vendore (NjQV), ishte përgjithësisht i kënaqshëm.
- Mbi 1 000 kandidatë për kryetarë të NjQV-ve dhe mbi 6 000 lista për këshilla u regjistruan në 384 NjQV, në një proces të përgjithshëm përfshirës.
- Si KQZ-ja ashtu edhe Kolegji Zgjedhor i kanë trajtuar ankimet dhe apelimet deri tani në mënyrë transparente dhe profesionale.
- Mediat u dhanë zgjedhësve informacion të gjerë mbi zgjedhjet, si para ashtu edhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës.

Mangësi, përfshirë disa që rrjedhin nga ndryshimet e 13 janarit, u vërejtën si më poshtë:

- Ndryshimet e 13 janarit sollën dispozita të reja kalimtare për identifikimin e zgjedhësve. Ndonëse këto dispozita kishin për synim forcimin e integritetit të procesit, ato kanë, gjithashtu, potencialin për t'u mohuar zgjedhësve të drejtën e votës.
- Certifikatat e lindjes, si mjet identifikimi për zgjedhësit, mbetën një çështje e debatuar. Përpjekje për të zgjidhur situatën çuan në miratimin e procedurave që provuan të ishin të rënda për zyrat e gjendjes civile (ZGjC), komisionet e qendrave të votimit (KQV) dhe zgjedhësit.
- Dispozita të veçanta për identifikimin e emigrantëve si në listat e zgjedhësve ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve ishin diskriminuese, lejonin vend për abuzime dhe mund të kenë çuar në mohimin e të drejtës së votës për zgjedhësit.
- Ngritja e vonë dhe disa herë e paplotë e administratës zgjedhore, përfshirë dy anëtarët e rinj të KQZ-së, ndikoi negativisht mbi procesin, veçanërisht në mungesë të mekanizmave alternativë për plotësimin e vendeve bosh në rast se partitë nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për të propozuar anëtarë për komisionet e nivelit të dytë dhe të tretë.
- Mundësia për rirënditje të kandidatëve për këshilltarë pas votimit kufizon transparencën.
- Në pak raste, kandidatët që u përpoqën të regjistrohen si të pavarur, u duk të kenë hasur pengesa të pajustificuara.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë. Megjithatë, kjo u eklipsua nga mangësi proceduriale dhe, me raste, nga tensione. Duket se mangësitë ishin pjesërisht rrjedhojë e aspekteve të ndryshimeve të 13 janarit, në pjesën më të madhe nevoja për një regjistër të posaçëm për certifikatat Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

e lindjes. Në një përqindje domethënëse prej 13 për qind të Qendrave të Votimit (QV) të vizituara, këto regjistra nuk ishin siguruar. Vonesa në procedurat e hapjes u vëzhguan shpesh dhe rreth 75 QV nuk u hapën. Boja e dukshme e përdorur për të shenjuar zgjedhësit ngriti polemika. Në një përqindje të lartë prej 31 për qind të QV-ve, pati votim në grup. Në Tiranë, ngjyra të ngjashme të fletëve të votimit për zgjedhje të ndryshme mund të kenë çuar në pështjellim. Ndërkohë që transferimi i materialeve zgjedhore në qendrat e numërimit të votave u duk se u bë sipas rregullave, vëzhguesit vërejtën se vetë numërimi i votave është zhvilluar me ngadalësi. Deri në orën 12.00 të dates 19 shkurt, KQZ-ja nuk kishte publikuar rezultate paraprake në faqen e saj të internetit.

Organizatat e përfaqësuar në MNVZ qendrojnë të gatshme të vazhdojnë mbështetjen e tyre për përpjekjet e autoriteteve shqiptare, partive politike dhe shoqërisë civile për përmirësimin e procesit zgjedhor në Shqipëri, në përputhje me Angazhimet e OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

GJETJE PARAPRAKE

Historik

Zgjedhjet e 18 shkurtit 2007 për organet e qeverisjes vendore ishin të tretat të vëzhguara nga OSBE/ODIHR-i në Shqipëri¹. Ato u mbajtën në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese të miratuara më 13 janar 2007, të cilat zgjatën mandatin e organeve të qeverisjes vendore nga tre në katër vjet.

Zgjedhjet u shtynë me afro një muaj nga 20 janari 2007, datë e dekretuar fillimisht nga Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu. Mbajtja e zgjedhjeve në datën fillestare u vonua nga polarizimi i vazhdueshëm dhe qendrime jo të hapura për kompromis nga të dy krahët e spektrit politik. Partitë në opozitë zgjodhën të mos regjistroheshin për zgjedhjet e 20 janarit 2007 apo të mos propozonin përfaqësuesit e tyre për Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV), me argumentin se refuzonin të merrnin pjesë në atë që ato e quanin ‘një proces i paligjshëm’.

Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, u bë gjithmonë e më e qartë se zhvillimi i zgjedhjeve nuk do të ishte i mundur pa arritjen e një marrëveshjeje midis shumicës dhe opozitës. Kjo vinte, së pari, për shkak të strukturave bipartizane të administratës zgjedhore, që lejonte bllokim nga forcat politike, si dhe faktit se ndryshimi i Kodit Zgjedhor kërkon një shumicë të cilësuar prej 3/5.

Vetëm në sajë të një nisme të Presidentit për të ulur së bashku të dy palët në një tryezë të rrumbullakët, me mbështetje të fuqishme ndërkombëtare dhe me përfshirjen e të dërguarit të Kryetarit të Rradhës së OSBE-së, Ambasadorit Jose Pons, u bë e mundur arritja e një marrëveshjeje politike më në fund më 12 janar. Kjo mundësoi miratimin e ndryshimeve vijuese në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor ditën e nesërme. Më 14 janar, Presidenti Moisiu ridekretoi zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore më 18 shkurt, dy ditë para përfundimit të mandatit kushtetues të NjQV-ve.

Sistemi Zgjedhor dhe Kuadri Ligjor

Kryetarët dhe anëtarët e këshillave të 384 NjQV-ve në Republikën e Shqipërisë zgjidhen me votim të përgjithshëm në një raund të vetëm votimi. Vendet në këshillat vendorë shpërndahen në bazë të listave të partive, duke përdorur një sistem përfaqësimi proporcional. Mund të garojnë edhe kandidatët të pavarur. Kandidatët për kryetarë zgjidhen në konkurimin fiton ai që renditet i pari.

¹ OSBE/ODIHR-i vëzhgoi zgjedhjet për Kuvendin në vitet 1996, 1997, 2001, 2005; referendumin për kushtetutën në vitin 1998, si dhe zgjedhjet vendore në vitet 2000 dhe 2003. Kongresi vëzhgoi zgjedhjet vendore në vitet 2000 dhe 2003. Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

Kuadri ekzistues zgjedhor mund të sigurojë bazë të mjaftueshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike nëse zbatohet me mirëbesim. Ndryshimet e kohëve të fundit në Kodin Zgjedhor lidhen, *ndër të tjera*, me administratën zgjedhore, listat e kandidatëve, identifikimin e zgjedhësve, pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe trajtimin e ankimeve zgjedhore. Ndonëse disa ndryshime kanë trajtuar një numër rekomandimesh të OSBE/ODIHR-it, veçanërisht ato për numërimin e votave dhe procesin e ankimeve dhe apelimeve, ndryshime të tjera ngrejné shqetësim. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës nuk u përfshi në hartimin e ndryshimeve të 13 janarit.

Shtirja e një dispozite që lejon rirenditjen e kandidatëve në listat shumemërore pas ditës së zgjedhjeve edhe tek zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas formulave të paraqitura gjatë regjistrimit, kufizon transparencën dhe ndikon mbi shpërndarjen e mandateve brenda listave të kandidatëve. Në rekomandimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2004, ishte vërejtur se lejimi i rirenditjes apo renditja ‘përfundimtare’ e kandidatëve pasi zgjedhësi ka hedhur votën do të ishte në kundërshtim me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde ndërkombëtare. Një mundësi e tillë, që ekziston për zgjedhjet për Kuvendin, u kritikua edhe në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005.

Më tej, dispozitat e reja kalimtare, sollën procedura të rënda për identifikimin e zgjedhësve si dhe rregulla diskriminuese për shtetasit që kanë emigruar. Megjithëse këto procedura u sollën me qëllim përmirësimin e integritetit të procesit, ato, gjithashtu, krijojnë mundësinë për mohimin e të drejtës së votës për zgjedhësit. Shqetësim të veçantë përbën kërkesa që, me qëllim marrjen e fletës së votimit, emigrantët duhet të paraqesin veç një pasaporte shqiptare edhe një dokument të dytë lëshuar nga shteti i vendbanimit të përhershëm të emigrantit. Dokumente të tilla mund të mos jepen nga të gjitha shtetet apo mund të ketë shtetas shqiptarë që nuk kanë qenë në gjendje të regjistrojnë vendbanimin e përhershëm jashtë vendit.

Administrata Zgjedhore

Marrëveshja politike e arritur në janar 2007 ruajti parimin e ‘balancimit politik’ të administratës zgjedhore ndërkohë që rriti numrin e anëtarëve. Një ndryshim kushtetues miratuar më 13 janar rriti numrin e anëtarëve të KQZ-së nga shtatë në nëntë; dy anëtarët e rinj u zgjodhën më 6 shkurt nga Kuvendi. Më 9 shkurt, kryetari i KQZ-së u rizgjodh nga anëtarët e KQZ-së për një mandat tre vjet e gjysmë. Vonesa në propozimin e dy anëtarëve të rinj të KQZ-së, siç kërkohet nga ndryshimet në ligjin zgjedhor, bëri që ata të zgjidheshin vetëm dy javë para ditës së zgjedhjeve. Këto emërimet kaq të vona, në fillim shkaktuar nga mungesa e propozimeve nga partitë politike, kontribuan në rritjen e tensioneve politike.

Numri i anëtarëve të KZQV-ve, KQV-ve dhe Grupeve të Numërimit (GN) u rrit nga 7 në 13, ku gjashtë grupet më të mëdha parlamentare nga shumica dhe pakica kishin të drejtën për të propozuar anëtarë. Dy partitë më të mëdha, PD-ja dhe PS-ja, ruajnë të drejtën të propozojnë kryetarët. Ngritja e KZQV-ve u pengua disi nga vështirësitë e hasura nga parti të tjera për të paraqitur propozime për të gjitha vendet parashikuar për to nga ndryshimet. Po ashtu, e drejta e partive për të zëvendësuar anëtarët e tyre në KZQV në çdo kohë krijoi probleme, pasi më shumë se një e treta e anëtarëve të KZQV-ve u zëvendësua, duke ndikuar mbi qendrueshmërinë e administratës zgjedhore. Më 11 shkurt, Kryetari i KQZ-së u bëri thirrje publikisht partive t’i japin fund kësaj praktike. Gjithsesi, zëvendësimet vazhduan gjatë javës para ditës së zgjedhjeve. Emërimi me vonesë i një numri domethënës të 66 000 anëtarëve të KQV-ve zvogëloi efikasitetin e administratës, në veçanti kur shumë prej tyre nuk ishin trajnuar.

Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

Pavarësisht një mjedisi të pasigurtë, një klimë politike të ngarkuar dhe afateve të ngjeshura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ishte në gjendje të menaxhonte deri tani procesin zgjedhor në përputhje me kuadrin ligjor.

Regjistrimi i Zgjedhësve

Në vijim të marrëveshjes politike të 12 janarit, bashkëpunimi midis zyrave të gjendjes civile (ZGjC) në NjQV-të dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGjC) në Ministrinë e Brendshme (MB) rifilloi në një nivel që lejoi përditësimin e listave të zgjedhësve dhe, deri në një shkallë të caktuar, heqjen e rekordeve të shumëfishta. Përmirësimet në saktësinë e regjistrimit themeltar të vendbanimit dhe përdorimi i gjerë i *software*-it të posaçëm të përdorur nga MB-ja duket të ketë çuar në lista më të sakta të zgjedhësve në shumë NjQV krahasuar me zgjedhjet e vitit 2005. Megjithatë, mungesa e një sistemi të duhur adresash, si dhe përfshirja e regjistrimit të përkohshëm në regjistrin themeltar, e kanë mbajtur numrin e ashtuquajtur 'kodet 999 (d.m.th. shtetas pa një adresë numerike të plotë) relativisht të lartë. Në bashkinë e Vlorës, për shembull, 48 për qind e gjithë zgjedhësve të regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve vazhdonin të ishin të shënuar me 'kodin 999'.

Afatet e ngjeshura ligjore për hartimin e listave të zgjedhësve u shkelën në mënyrë të përsëritur nga një numër NjQV-shë kryesisht sa i takon dërgimit të listave paraprake në DPGjC dhe afishimit të listave paraprake apo përfundimtare të zgjedhësve për rishikim nga publiku. Partitë politike i nxitën në mënyrë aktive mbështetësit e tyre të kontrollonin listat e zgjedhësve pas afishimit të tyre. Në raste të tjera, p.sh. në Shkodër, partitë paraqitën në emër të zgjedhësve kërkesa për ndreqje gabimesh, megjithëse kjo është në kundërshtim me ligjin.

Në shumë prej NjQV-ve, identifikimi i zgjedhësve emigrantë, sipas dispozitave të posaçme parashikuar nga ndryshimet e 13 janarit, u krye nga grupet për njoftimin e zgjedhësve. Pati mungesë njëtrajtshmërie në zbatimin e këtyre dispozitave të posaçme, përfshirë në lidhje me ngritjen e grupeve të identifikimit, përbërjen e tyre dhe metodologjinë e punës. Autoritetet e qeverisjes vendore, shpesh i trajtuan konstatimet e tyre me arbitraritet. Faktorë të tillë mund të kenë kontribuar më tej në mohimin e të drejtës së votës.

Certifikatat e Lindjes

Në mungesë të vazhdueshme të dokumenteve të reja shqiptare për identifikimin e shtetasve për të gjithë popullsinë, certifikatat e lindjes mbeten një formë e përdorur gjerësisht për identifikimin e shtetasve. Certifikatat e lindjes me fotografi, së bashku me pasaportat dhe letërnjoftimet, janë forma të dokumenteve të identifikimit të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Përdorimi i vazhdueshëm i certifikatave të lindjes si mjet identifikimi për zgjedhësit ka qenë në qendër të mosmarrëveshjeve të mëdha ndërmjet shumicës qeverisëse dhe opozitës gjatë gjithë periudhës zgjedhore. Opozita ngriti pretendimin se kishte hapësirë të gjerë për manipulimin e lëshimit dhe administrimit të certifikatave të lindjes, si edhe mungesë të sigurisë së përdorimit për shkak të dobësive në regjistrimin e tyre. Qeveria, nga ana e saj, pretendoi se problemi u krijua artificialisht dhe se kishte elemente të mjaftueshme sigurie për parandalimin e keqpërdorimit të certifikatave. Në nëntor 2006, Ministri i Brendshëm nxori një udhëzim që detyronte të gjitha ZGjC-të të mbanin një regjistër të posaçëm në të cilin do të regjistroheshin të gjitha certifikatat e lëshuara. Megjithatë, në disa NjQV, regjistrat e posaçëm nuk u krijuan deri në fund të vitit 2006. Në shumë raste, regjistrat e posaçëm u krijuan midis mesit të nëntorit dhe fillimit të dhjetorit 2006.

Performanca e ZGjC-ve nxiti mosmarrëveshjet midis MB-së dhe PS-së. Më 23 janar 2007, Minsitria e Brendshme nxori një 'kujtesë' për të gjitha ZGjC-të, ku akuzoheshin disa kryetarë të njësive të Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

qeverisjes vendore se kishin penguar në mënyrë të paligjshme punën e ZGjC-ve duke e kushtëzuar lëshimin e certifikatave me pagesën e taksave vendore. Më tej, dokumenti udhëzonte ZGjC-të për t'u dhënë shtetasve, që nuk kishin ndonjë dokument tjetër identifikimi, certifikata lindjeje për qëllime zgjedhore falas. PS-ja akuzoi MB-në për lehtësim të lëshimit të paligjshëm të certifikatave me pretendimin se ishin për qëllime falsifikimi. Qeveria u përgjigj se sipas Ligjit për Gjendjen Civile, punonjësit e ZGjC-ve nuk mund të lëshojnë certifikata false dhe shtetasit duhet të paraqesin të dhëna të vërteta në lidhje me identitetin e tyre; sipas MB-së, përgjegjësia ekzistuese penale duhet të jetë një shkrajues i mjaftueshëm për çdo abuzim me certifikatat e lindjes.

Po ashtu, zbatimi i dispozitave të reja kalimtare të Kodit Zgjedhor që parashikojnë ngritjen e grupeve për monitorimin e punës së ZGjC-ve në qendrat administrative të 12 qarqeve përbënte polemikë. Këto grupe prej dy personash u ngritën nga Prefektë të qarqeve të emëruar nga qeveria dhe duhej të përfshinin të paktën një anëtar të propozuar nga opozita në nivel vendor. Në Tiranë, kryetarët e disa njësisive bashkiake refuzuan të lejojnë grupet e monitorimit për të kryer detyrat e tyre, me argumentin se njësitë bashkiake të Tiranës nuk kanë statusin e qendrave administrative. Në të vërtetë, ndarja specifike administrative-territoriale e Bashkisë së Tiranës nuk ishte marrë parasysh në marrëveshjen e 12 janarit. Megjithatë, qendrimi i ndërmarë nga ana e këtyre Kryetarëve u duk të dëmtojë atë që kishte për synim një masë për ndërtimin e mirëbesimit.

Regjistrimi i Kandidatëve

Sipas dispozitave kalimtare të Kodit Zgjedhor, afatet kohore për ngritjen e KZQV-ve dhe për regjistrimin e kandidatëve pothuajse përkuan në të njëjtën kohë. Fakti se një numër KZQV-shë nuk u ngritën brenda afatit ligjor e kufizoi më tej kohën në dispozicion për regjistrimin e kandidatëve. KZQV-të regjistruan gjithsej 1 073 kandidatë për kryetarë të NjQV-ve dhe 6 074 lista partish apo koalicionesh për këshillat vendorë, si edhe 212 kandidatë të pavarur për këshilltarë.

Me raste, zyrtarët në detyrë dhe aktivistë të tjerë partiakë, që nuk u propozuan nga partitë e tyre për shkak të marrëveshjeve politike brenda të dyja aleancave kryesore, u regjistruan ose u përpoqën të regjistroheshin si kandidatë të pavarur. Kandidatë të pavarur, që nuk janë në detyrë apo nuk mbajnë një vend në këshill ose Kuvend, duhet të paraqesin një numër nënshkrimesh mbështetëse nga zgjedhës të regjistruar në listën paraprake të NjQV-së përkatëse. Në disa raste, regjistrimi i tyre u refuzua nga KZQV-të, që vunë në dyshim vërtetësinë e nënshkrimeve mbështetëse të paraqitura.

Mungesa e një udhëzimi nga KQZ-ja për verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse nga ana e KZQV-ve ngriti polemika. Për pasojë, disa prej kandidatëve të refuzuar që apeluan vendimet e KZQV-së në KQZ dhe Kolegj Zgjedhor u regjistruan më pas.

Mjedisi i Fushatës

Gjatë gjithë periudhës parazgjedhore, fushata u karakterizua nga një përfshirje aktive e partive politike dhe kandidatëve të pavarur. Megjithëse mjedisi i përgjithshëm i fushatës mbeti i qetë, fushata ishte disa herë e ngarkuar me tension dhe në disa raste u vërejtën incidente të dhunshme.

Të dy krahët e spektrit politik patën një start të shpejtë të fushatës pas ridekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti Moisiu. Partitë e shumicës parlamentare u grupuan në një aleancë nëntë-partiake, që përfshinte gjashtë parti parlamentare dhe tri parti jashtë Kuvendit. Gjithsesi, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ndoqi një strategji për lidhje të aleancave në nivel vendor. Opozita parlamentare u grupua në një aleancë pesë-partiake. Secila prej aleancave doli me kandidatë të përbashkët për kryetarë të NjQV-ve, por me lista të veçanta për këshillat vendorë. Asnjë krah nuk u regjistrua si koalicion.

Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

Të dy krahet patën probleme domethënëse në ruajtjen e disiplinës së brendshme të partisë, dhe fushata u shënua nga një numër i qenësishëm i kandidatëve 'të pavarur' që u shkëputën nga rradhët e partisë me qëllim kandidimin kundër partnerëve të ish-partisë së tyre. Gjithashtu, pati të dhëna se, në raste të caktuara, ishte ushtruar trysni mbi këta kandidatë të pavarur për t'u tërhequr me qëllim mosndarjen e votës. Në PS, kjo çështje u bë një element domethënës i debatit të brendshëm, ku deputetë të caktuar të PS-së vunë në pikëpyetje transparencën e aleancës.

Bashkëbiseduesit vunë re pak probleme në lidhje me aftësinë e tyre për fushatë. Megjithatë, u vërejtën disa raste të shkatërrimit të posterave nga kundërshtarët, dhe në pak raste kjo rrodhi në dhunë. Gjatë një incidenti të tillë në Gjirokastrë, u nxorën thika dhe një armë zjarri. Në Tiranë, aktivistë të PD-së pretenduan se ishin rrahur nga një deputet i PS-së. Më 15 shkurt, pati një shpërthim në një restorant të Tiranës pak kohë pas largimit të kryetarit të PS-së; nuk pati persona dëmtuar nga shpërthimi dhe është e paqartë nëse incidenti kishte lidhje me zgjedhjet. Megjithëse mesazhet e fushatës u përqendruan kryesisht në kritika nga secila palë kundër tjetrës, ato përfshinin edhe disa propozime programatike.

Pretendime shumta për keqpërdorimin e burimeve të shtetit dolën afër ditës së zgjedhjeve. Në Korçë, një punonjës i një qendre të kujdesit shëndetësor u pushua pa paralajmërim. Personi pretendoi se pushimi erdhi pasi ishte aktivist i PS-së në një administratë të PD-së. Apeluesi tentoi ta çonte çështjen në gjykatë.

Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare dhe e Grave

Në këto zgjedhje, gratë u përzgjodhën rrallë si kandidatë. Nga 1 073 kandidatët për kryetarë të NjQV-ve, vetëm 33 ishin gra (3 për qind). Një numër partishë politike përcaktuan kuota të brendshme gjinore në këto zgjedhje (në disa raste, deri në 50 për qind), por mbetet për t'u parë se si do të ndikohen këto kuota nga zbatimi i rirënditjes. Në 16 për qind të QV-ve të vizituara, KQV-të kryesoheshin nga gra.

Ka një mungesë të të dhënave të besueshme aktuale zyrtare për pakicat kombëtare në Shqipëri. Megjithatë, pranohet gjerësisht se grupimi më i madh i pakicave është ai i shtetasve shqiptarë me kombësi greke. Po ashtu, në Shqipëri jetojnë komunitete me bullgarë, maqedonas etnikë, romë, serbë dhe vlllehë. Një numër çështjesh të lidhura me zgjedhjet u ngritën brenda komunitetit rom në këto zgjedhje. Probleme specifike u vërejtën me përfshirjen e tyre në listat e zgjedhësve duke qenë se shumë romë ose nuk ishin regjistruar si duhet në vendbanimin e tyre, ose nuk ishin regjistruar fare. Pati gjithashtu pretendime për blerje të votës në komunitete romë nga kandidatë; në Pogradec u vërtetua një rast për një kandidat të PD-së.

Media

Shqipëria ka një mjedis mediatik pluralist, me transmetues publikë dhe privatë si dhe media të printuar të larmishme. Radioja dhe televizioni publik repsektuan detyrimin ligjor për minutazh transmetimi falas për të gjitha partitë e regjistruara për zgjedhje. Debate televizive u transmetuan rregullisht si në TV publik ashtu edhe në një numër transmetuesish të tjerë, duke u siguruar kandidatëve një forum për shkëmbim pikëpamjesh. Përgjithësisht, zgjedhësve iu dha një informacion i gjerë në lidhje me zgjedhjet; sidoqoftë, mediat u përqendruan kryesisht në dy partitë e mëdha dhe partitë e vogla u pasqyruan më pak sesa e drejta që u njihet me ligj.

Kodi Zgjedhor rregullon pasqyrimin e fushatës në media. Transmetuesve publikë dhe privatë u kërkohet të pasqyrojnë fushatat e partive sipas peshës së tyre relative në Kuvend. Përmbushja e këtij Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

detyrimi mbikqyret nga Bordi i KQZ-së për Monitormin e Mediave (BMM). Pavarësisht vonesave në nisjen e përpjekjes së tij monitoruese, në shkallë vendi dhe vendore, si dhe problemeve me monitoruesit dhe pajisjet në një numër qarqesh, BMM-ja ishte në gjendje të përmbushte mandatin e vet. Mbështetur në raportet e BMM-së, KQZ-ja urdhëroi një numër mediash të “korrigjojnë” pabarazinë në pasqyrimin e fushatës. Gjithsesi, KQZ-ja hodhi poshtë dy kërkesa për kompensim nga parti të vogla (PAD-ja dhe PSD-ja), megjithëse monitorimi i BMM-së tregoi se këto pretendime dukej se ishin të bazuara.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi mediat kryesore elektronike dhe të shtypura² duke vlerësuar kohën dhe hapësirën e dhënë për të gjithë kandidatët dhe partitë që konkurronin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore si dhe tonin e pasqyrimin. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, TVSH-ja i dha PD-së 28 për qind të pasqyrimin të hapësirës politike dhe lajmeve kryesore për zgjedhjet, kryesisht me tone pozitive ose neutrale. PS-ja mori 29 për qind, gjithashtu kryesisht pozitive ose neutrale. Pasqyrimi i dy partive kryesore nga TV Arbëria, Top Channel, Vizion+ dhe News24 ishte i ngjashëm me TVSH-në. TV Klan përdori një qasje ndryshe duke i dhënë PS-së 28 për qind dhe PD-se 21 për qind. Operatori televiziv shpesh paraqiti zyrtarë shtetërorë si përfaqësues të qeverisë edhe kur ata merrnin pjesë në veprimtari të fushatës. TV Klan i dha Qeverisë 23 për qind të minutazhit politik, më i larti i mediave të monitoruara.

Ankimet dhe Apelimet

KQZ-ja regjistroi dhe shqyrtoi mbi 50 kërkesa ankimore, pjesa më e madhe e të cilave kundër vendimeve të KQZ-ve lidhur me regjistrimin e kandidatëve. Shtatëmbëdhjetë vendime të KQZ-së u apelian në Kolegjin Zgjedhor, gjashtë prej të cilave u hodhën poshtë. Nga tetë apelimet nga kandidatët të refuzuar apo çregjistruar, Kolegji Zgjedhor hodhi poshtë vendimet e KQZ-së në katër raste për mungesë të bazës ligjore dhe/ose të pa mbështetura me prova të mjaftueshme. Si KQZ-ja edhe Kolegji Zgjedhor i trajtuan kërkesat ankimore në mënyrë transparente dhe profesionale dhe në përgjithësi i respektuan afatet për marrjen e vendimeve.

Vëzhguesit Vendas dhe Ndërkombëtarë

Sipas nenit 18 të Kodit Zgjedhor, organizata jofitimprurëse (OJF) shqiptare kanë të drejtën të vëzhgojnë zgjedhjet. Në këto zgjedhje, nisma më e madhe e shoqërisë civile u organizua nga ‘Koalicioni i OJF-ve Vendase’, një organizatë ombrellë që përfshiu shtatë grupe vendase dhe shpërndau rreth 3000 vëzhgues vendorë në gjithë vendin për monitorimin e procedurave të hapjes, votimit, numërimit, dhe nxjerrjes së rezultatit.

Dita e Zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë. Megjithatë, kjo tablo u eklipsua nga mangësi procedurale dhe organizative dhe, në një numër NjQV-shë, nga tension. Disa probleme të vërejtura rrodhën nga zbatimi i marrëveshjes së 12 janarit. Përgjithësisht, vëzhguesit e MNVZ-së e karakterizuan procesin e votimit si ‘keq’ apo ‘shumë keq’ në 10 për qind të Qendrave të Votimit (QV) të vizituara. Ankime zyrtare u paraqitën në 6 për qind të QV-ve të vizituara.

Në një përqindje domethënëse prej 13 për qind të QV-ve të vizituara, regjistri i posaçëm për certifikatat e lindjes nuk ishte dërguar. Kjo u duk të ishte kryesisht për shkak të pasigurisë se kush ishte përgjegjës për t’i dërguar. Në disa QV, kjo pengoi procesin e votimit. Aty ku kishte kopje të

2 TV: TVSH (publik), TV Klan (privat, licencë kombëtare), TVA (TV Arbëria; (privat, licencë kombëtare), Top Channel (privat, licencë rajonale), Vizion + (privat, licencë rajonale) dhe News24 (privat, licencë rajonale), Gazeta: *Gazeta Shqiptare*, *Shekulli* dhe *Shqip*.

Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

regjistrin të posaçëm, në disa raste nuk përdorej; për shembull në Njësinë Bashkiake 7 në Tiranë, Kamëz, Gjirokastër, Berat dhe Poliçan. Në 20 për qind të QV-ve të vëzhguara, certifikatat e lindjes nuk u kontrolluan me regjistrin e posaçëm, dhe në 29 për qind, ato nuk u mbajtën nga KQV-ja.

Pjesa më e madhe e ZGjC-ve të vizituara menjëherë para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve ishin hapur dhe në 49 për qind të tyre, një numër i madh shtetasish ishin duke pritur për të marrë certifikatë lindjeje. Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën mungesë njëtrajtshmërie në lidhje me orarin e punës së ZGjC-ve në ditën e zgjedhjeve. Partitë politike pretenduan abuzim me certifikatat në disa NjQV.

Në 34 për qind të QV-ve të vëzhguara, zgjedhësit u kthyen mbrapsht për shkak se emrat e tyre nuk ishin në listat e zgjedhësve. Megjithatë, numri i njerëzve të prekur nga kjo ishte i vogël në pothuajse të gjitha rastet. Njerëzit e shënuar si emigrantë në listat e zgjedhësve nuk hasën probleme të pajustificuara në votim. Boja e dukshme përdorur për të shenjuar votuesit ishte në qendër të polemikave ku kishte pretendime se ajo mund të fshihej lehtë. Në 20 për qind të QV-ve të vizituara, zgjedhësit u kontrolluan rrallë ose asnjëherë për gjurmë të bojës, dhe në 11 për qind, boja u aplikua rrallë ose asnjëherë.

Pjesa më e madhe e QV-ve ku u vëzhgua hapja e votimit, disa herë u hapën me vonesa të konsiderueshme; kjo u duk se erdhi për shkak të mbërritjes me vonesë apo të paplotë të materialeve zgjedhore apo emërimit me vonesë të anëtarëve të KQV-ve, disa prej të cilëve nuk u emëruan deri në mbrëmjen pararendëse. Rreth 75 QV nuk u hapën fare. Në Njësinë Bashkiake 1 në Tiranë, kryetari ndryshoi numrin e QV-ve pas afatit ligjor; si rrjedhojë, KQV-të morën listat e gabuara të zgjedhësve dhe sasinë e gabuar të fletëve të votimit.

Vëzhguesit raportuan tension apo rrëmujë në 7 për qind të QV-ve të vizituara si dhe raste të izoluara dhune. Persona të paautorizuar ndërhyjnë në proces në 4 për qind të QV-ve të vizituara. Në 4 për qind, persona po ndikonin ose po përpiqeshin të ndikonin mbi zgjedhësit. Raste të trysnisë mbi zgjedhësit u raportuan nga një numër i kufizuar NjQV-shë; për shembull Bushat dhe Gruemirë. Në një QV në Bushat, katër anëtarë të KQV-së nga partitë e shumicës u larguan dhe nuk u zëvendësuan pasi mbështetësit e Partisë Demokristiane 'kërkuan' të drejtën për t'i zëvendësuar.

Votimi në grup u vëzhgua në një përqindje të lartë prej 31 për qind të QV-ve. U raportuan gjithashtu, raste të izoluara të votimit për të tjerë apo atij të shumëfishtë. Më tej, vëzhguesit vërejtën shkelje të tjera të izoluara por serioze. Në një QV në Poshnjë, një anëtar i KQV-së po nënshkruante në listën e zgjedhësve kur aty nuk kishte asnjë zgjedhës. Në disa QV në Himarë, procesi u karakterizua si problematik. Në Himarë, një KQV u duk të bënte qëllimisht të pavlefshme fletët e votimit duke ua dhënë ato zgjedhësve me gjithë kundërftetën, duke i nënshkruar, apo duke mos i vulosur si duhet.

Në Tiranë, ngjyrat e ngjashme të disa fletëve të votimit, çuan në pështjellim dhe mund të kenë çuar në një numër të konsiderueshëm fletësh votimi të hedhura në kutinë e gabuar të votimit dhe, për rrjedhojë, të bëra të pavlefshme.

Vëzhguesit e partive apo kandidatëve ishin të pranishëm në 75 për qind të QV-ve të vizituara; vëzhguesit vendas jopartiakë, kryesisht nga 'Koalicioni i OJF-ve Vendase' u identifikuan në 33 për qind të QV-ve.

Vëzhguesit i përshkruan shumë mjedise të QV-ve si tepër të vogla e të papërshtatshme. Hyrja në 12 për qind të QV-ve të vizituara u konsiderua e vështirë, gjë që mund të ketë ndikuar në votimin nga ana e zgjedhësve me aftësi të kufizuar.

Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

Në disa NjQV, situata degradoi gjatë pasdites. Në disa njësi bashkiake të Tiranës, zgjedhës të shumtë dhe njerëz të tjerë u grumbulluan jashtë disa QV-ve, u raportua tension dhe disa QV u mbyllën me vonesa të konsiderueshme dhe në rrethana kaotike, ku zgjedhës që ishin duke pritur jashtë nuk u lejuan të votojnë.

Në vende të tjera, QV-të përgjithësisht u mbyllën në kohë, dhe pjesa më e madhe e vëzhguesve raportoi se zgjedhësit që prisnin në rradhë ishin në gjendje të votonin. Procedurat e mbylljes u respektuan në një shkallë të madhe. Megjithatë, kopje të procesverbalit të mbylljes nuk iu dha gjithmonë atyre që kishin të drejtën për t'i marrë. Gjithashtu, disa vëzhgues raportuan prezencën e personave të paautorizuar gjatë mbylljes.

Numërimi i Votave

Vëzhguesit raportuan se, në përgjithësi, pranimi i materialeve zgjedhore në qendrat e numërimit shkoi mirë. Pjesa më e madhe e problemeve u vërejt në NjQV-të e mëdha me shumë QV. Vëzhguesit raportuan se pranimi ishte i ngadaltë dhe i organizuar dobët në pjesën më të madhe të njërive bashkiake të Tiranës.

Në të gjitha qendrat e numërimit të vëzhguara, numërimi i votave filloi vetëm pasi materialet zgjedhore ishin marrë nga të gjitha QV-të. Në Gjirokastrë, numërimi u bllokua deri në orën 02.50 pas një incidenti të dhunshëm ku u përfshinë mbështetës të PS-së dhe PD-së. Në Bushat, numërimi u shty për të hënë në mëngjes pas pengesave nga deputeti i zonës dhe mbështetësit e tij.

Në Njësitë Bashkiake 1,6, dhe 10 në Tiranë numërimi nuk filloi deri në orën 06.00.

Deri në orën 12.00 të dates 19 shkurt, KQZ-ja nuk kishte publikuar rezultatin paraprak në faqen e saj të internetit.

OSBE/ODIHR-i do të nxjerrë komente të tjera në lidhje me procesin e numërimit në kohën e duhur.

INFORMACIONE MBI MISIONIN & FALENDERIME

Z. Jørgen Grunnet (Danimarkë) është Kryetari i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it.

Z. Jean-Claude Frécon (Francë) drejtoi delegacionin e Këshillit të Evropës të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it u ngrit në Tiranë më 13 dhjetor 2006 me 33 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë në Tiranë dhe dhjetë qendra rajonale. Ditën e zgjedhjeve, MNVZ-ja dërgoi rreht 345 vëzhgues afatshkurtër nga 39 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë një delegacion prej 17 anëtarësh me përfaqësues të zgjedhur të autoriteteve vendore evropiane nga Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës.

MNVZ-ja vëzhgoi votimin në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në 1 069 qendra votimi nga 4 721 gjithsej, në 247 prej 384 njërive të qeverisjes vendore. Deri në orën 10.00 të dates 19 shkurt, vëzhgimi i numërimit vazhdonte.

MNVZ-ja dëshiron të falenderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe autoritete të tjera kombëtare dhe lokale për ndihmesën dhe bashkëpunimin e tyre gjatë vëzhgimit. MNVZ-ja dëshiron të shprehë vlerësim edhe për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe ambasadave për mbështetjen e tyre gjatë kohëzgjatjes së Misionit.

Për informacione të mëtejshme, jeni të lutur të kontaktoni:

- Z. Jørgen Grunnet, Kryetari i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, në Tiranë (+355-4-254 470);

Ky raport është i përkthyer në shqipe. Në çdo rast, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

- Zj. Urdur Gunnarsdottir, Zëdhënëse e OSBE/ODIHR-it (+48-603-683 122); ose Z. Gilles Saphy, Këshilltar për Zgjedhjet i OSBE/ODIHR-it, Varshavë (+48.22.520.06.00);
- Z. Jean Philippe Bozouls, Kongresi i Këshillit të Evropës, Strazburg (+33 3 88 412007)